

## PROPOZIM KONKLuzionET E KËSHILLIT

1. Duke i përsëritur konkluzionet e veta të 14 dhjetorit 2021, Këshilli e përshëndet përcaktimin e vazhdueshëm të Maqedonisë së Veriut për të vazhduar me agjendën e reformave të Bashkimit Evropian dhe për të ofruar rezultate të dukshme dhe të qëndrueshme.
2. Në rrugën e Maqedonisë së Veriut drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Këshilli rikujton rëndësinë e arritjes së rezultateve të dukshme dhe të zbatimit të marrëveshjeve bilaterale me vullnet të mirë, përfshirë edhe Marrëveshjen e Prespës me Greqinë dhe Marrëveshjen e Miqësisë, Fqinjës së Mirë dhe Bashkëpunimit me Bullgarinë.
3. Në këtë drejtim, Këshilli e përshëndet marrëveshjen për protokollin e takimit të dytë të Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar të themeluar në përputhje me nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.  
Ky hap i rëndësishëm do të kontribuojë në marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe në bashkëpunimin rajonal që mbeten elemente thelbësore të procesit të zgjerimit, si dhe të Procesit të Stabilizim - Asocimit.
4. Gjithashtu do të mundësojë përforcimin e të drejtave të barabarta të pjesëtareve të pakicave dhe komuniteteve në Maqedoninë e Veriut, dhe si i tillë, do të kontribuojë në harmonizimin me Kriteret politike të Kopenhagës. Në këtë drejtim, Këshilli e përshëndet synimin e Maqedonisë së Veriut për të filluar dhe me prioritet t'i arrijë ndryshimet relevante kushtetuese, me qëllim që në kushtetutë të përfshihen qytetarë që jetojnë në suaza të kufijve të shtetit dhe që janë pjesë e popujve të tjerë, siç janë bullgarët.
5. Duke e marrë parasysh në tërësi këtë progres dhe harmonizimin e pandërprerë në të gjitha fushat të identifikuar nga Këshilli, në qershor të vitit 2018, Këshilli vendosi që ta miratojë Kornizën Negociuese dhe, në përputhje me Metodologjinë e përmirësuar, dhe vendimin për hapjen e negociatave për anëtarësim të sjellë më 25 mars 2020, të mbajë konferencën politike ndërqeveritare me Maqedoninë e Veriut në (vendi dhe data) me qëllim që të prezantohen hapat e radhës nga procesi i zgjerimit, sipas miratimit të Kornizës Negociuese, siç është përshkruar në "Deklaratën hyrëse të BE-së".
6. Me qëllim që të përfundojë kjo fazë e hapjes së negociatave për anëtarësim, Këshilli gjithashtu vendosë të thërrasë një konferencë tjetër ndërqeveritare me qëllim që ta prezantojë Kornizën Negociuese dhe situatën aktuale të punëve përgatitore, të kryera nga ana e Komisionit, dhe është i gatshëm ta mbajë atë, pa ndonjë vonesë shtesë, apo vendim plotësues politik, menjëherë sapo Maqedonia e Veriut ta ketë zbatuar zotimin për përfundimin e ndryshimeve të lartë theksuara kushtetuese në pajtueshmëri me procedurat e saja të brendshme.
7. Në këtë aspekt, Këshilli vlerëson se Komisioni ka arritur progres në punën e tij që ta zbatojë dhe përmbyllë procesin e shqyrtimit analitik të së drejtës së BE-së (acquis) dhe është i gatshëm që t'ia paraqesë rezultatet e tija Maqedonisë së Veriut. Duke u bazuar në këtë, Këshilli i bën thirrje Komisionit të vazhdojë ta vlerësojë shkallën e gatishmërisë së Maqedonisë së Veriut për hapjen e negociatave në fushat e caktuara, dhe t'i identifikojë çështjet që, me shumë gjasa, do të shfaqen gjatë negociatave, duke filluar me kapitullin vlerat fundamentale, që në përputhje me Kornizën Negociuese, do të hapet i pari, sapo Maqedonia e Veriut të ketë plotësuar kriteret përkatëse të dakorduara nga Këshilli.